



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Punimi - Projekti (MRO)na 2024-2023			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Emri	Shtetëse Prilog	Vlera Vredimes
01-060/01-336			



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008) dhe të nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

## F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e IV të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **27.04.2023 (e Enjte)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të shtëpisë së kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

## R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Kuvendit Komunal.
2. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2023.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e draft rregullores për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Vitisë.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e iniciativës për Bashkëpunim ndekomunal ndemjet Komunave përkatëse në fushën e Menaxhimit të mbeturinave
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e marrëveshjes së binjakëzimit mes Komunës së Vitisë dhe Komunës së Kirrhain Gjermani.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e planit komunal për Ri Integrimin e Qëndrueshëm të personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve në komunën e Vitisë.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit nr.01-110/05-108, të datës 01.02.2022, për plotësimin e vendimit nr. 01-110/05-974 të datës 28.12.2021 për formimin e Komiteti për Komunitete.

Viti, më 20.04.2023

Kryesuesi i Kuvendit  
Bekim Azizi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranor - Prilqenja Mëdha: 20-06-2023

Dir. i organit Org. broj	Numri/Broj	Statusi Prilog	Vlera Vendimes
01-060/01-	336		



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008) dhe të nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

## F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e IV të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **27.04.2023 (e Enjte)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të shtëpisë së kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

## R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Kuvendit Komunal.
2. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2023.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e draft rregullores për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Vitisë.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e iniciativës për Bashkëpunim ndekomunal ndemjet Komunave përkatëse në fushën e Menaxhimit të mbeturinave
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e marrëveshjes së binjakëzimit mes Komunës së Vitisë dhe Komunës së Kirchhain Gjermani.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e planit komunale për Ri Integrimin e Qëndrueshëm të personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve në komunën e Vitisë.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit nr.01-110/05-108, të datës 01.02.2022, për plotësimin e vendimit nr. 01-110/05-974 të datës 28.12.2021 për formimin e Komiteti për Komunitete.

Viti, më 20.04.2023

Kryesuesi i Kuvendit  
Bekim Azizi



# **PIKA E PAR E RENDIT TË DITË**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## Vërejtje: I lektoruar deri faqe pesë

### PROCESVERBAL

#### IMBLEDHJES SË TRETË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 30.03.2023 (e enjte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti si dhe këshilltarët e Kuvendit, si: z.Ramadan Deliu, z.Basri Sylejmani, z.Sokol Shaqiri, znj.Marigona Avdiu, znj.Valentina Mehmeti, z.Zejnepe Osmani, z.Ali Bajrami, z.Ekrem Ymeri, z.Arbnora Hajredini, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Sejdi Emini, z.Nexhat Halili, z.Remzi Salihu, z.Durim Sylejmani, znj.Lindita Demelezi, znj.Majlinda Shabani, z.Taulant Haxhiu, z.Musli Neziri, znj.Vilsona Maliqi-Salihu, znj.Zyrafete Rama, znj.Anisë Zejnullahu, z.Sokol Hyseni, z.Reshat Azizi, z.Illir Zuka, z.Veton Ramadani. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike dhe të tjerë.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e tretë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Të nderuar të pranishëm, media, qytetarë të Komunës së Vitisë, po fillojmë seancën e rregullt të Kuvendit Komunal në Viti. Duke pas parasysh që materialin e keni marrë me kohë, gjatë kësaj peridhe prej seances së kaluar nga pikat që i kemi miratu kemi marrë konfirmimin për 3 pika që janë konformë ligjit, ndërsa për 3 tjera ende nuk na ka ardhë konfirmimi, edhe pse ana ligjore thotë: nëse për 15 ditë nuk kthehet ajo është e pranuar, mirëpo me shkrim nuk na ka ardhë ndonjë konfirmim për 3 të tjera që po presim me ardhë. Ju kisha kërku, ata që nuk e kanë bërë deklarin e pasurisë, afati i fundit është deri neser me 31. Mundohuni edhe kryni obligimin ligjor të deklarimit të pasurisë për vitin që kemi lanë prapa. Para se me fillu me rend të ditës, vazhdojmë me pikën jashtë rendit të ditës pyetje përgjigje. Mundësisht të ju përmbahemi rregullores, nga 2 pyetje i keni, pastaj vazhdojmë me rend të ditës.

**z.Illir Zuka:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Drejtori i kulturës, a ka mundësi me na dhanë ndonjë informat rreth subvencioneve, kur do të përfundojnë. Dhe tjetra, drejtori i inspeksionit dhe urbanizmit, kemi problem me deponitë e bërlllogut në Pozheran. Unë e kam bërë një kërkesë në Drejtorinë e Inspeksionit për personat që i kanë hudhë, por po të bëjë kërkesë edhe si drejtor i urbanizmit. Vitin e kaluar e keni pas një aksion për largimin e mbeturinave, është rruga “Sabit Zuka”, është shumë e frekuentume, për shkak që është edhe afër fushes ku “Vllaznia” e Pozheranit i zhvillon ndeshjet dhe nuk është një pasqyrë e mirë për Komunën e Vitisë me qenë ajo deponi aty. Kisha kërku që me ndërmarrë diqka me largu prej aty. Faleminderit!

**z.Jakup Demiri:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Pyetja e parë është për komunën në lidhje me lumin “Morava”. A janë kanë këto ditë, po ja jap si informatë që lumi kur ta kalon minihydrocentralin është në një sasi gati se është. Kjo është gjendja dhe ne jemi kanë me pa kur e kemi dhanë leje, kemi pas fol shumë dhe tashti lumi “Morava” thuja se është ndalë tërësisht. Unë kam qenë të Dielen aty, e kam shiku, është mirë me shku me kqyrë se



vazhdu punimet në disa objekte banesore këtu në Viti dhe po e pyes drejtorin e inspeksionit edhe komunën në këtë rastë a kanë leje këta operatorë që vazhdojnë me këto mbindertime edhe nga 4 kate mbindertime ka këtu. A është tejkalu etazhiteti dhe a po vazhdonë si të kalumen edhe ky vitë me këtë qeverisje me këto mbindertime ne qytezen tonë të Vitisë.

**znj.Arbnore Hajredini:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! E kam një pyetje, por nuk e di ku mund ta gjej përgjigjen e kësaj pyetje. Te Zyra e Personelit, që po tregohen që është më e fuqishmja në komunë apo te drejtoritë përkatëse. Pyetja është për mohimin e qytetarëve ndaj konkurseve publike, si në arsim, si në shëndetësi ose punësimi pa konkurs me anë të rradhitjeve të pazareve. Nuk është e mundur të përfundosh fakultetin me 10 e me bursa të juajat e me qenë në fund të listës në provim me shkrim delë e para kurse me gojë kur nuk dihet kush e pyet del e fundit në cilin ligjë jeni bazu që e keni bërë këtë listë ku në ligjë të punës nuk përmendet lista po më brengosë opozita që po heshtë ndaj kësaj liste apo edhe kjo është pjesë e këtyre pazareve nuk e di a e dinë qytetaret që është veper penale që pa konkurs të jashtëm të pranohen njerëzit në punë në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës ajo nuk është i pranishmit një i ri në punë nëse mirret në bazë të asaj liste, por është emrim. Kësaj rradhe po kursehem, por në seancat e tjera do të jem më e kjoartë me emra, mbiemra.

**z.Sokol Shaqiri:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë e kam një kërkesë për drejtorin e shërbimeve publike. Rruga "Hysen Terpeza", Kllokot-Terpezë është në gjendje shumë të keqe. Tashti janë kriju edhe gropa të mëdha, edhe kështu që, çdo të tretën ditë ka aksidente. Kisha dashtë një përgjigje prej drejtorisë çka ka mundësi me bë. Faleminderit!

**z.Taulant Haxhiu:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Te rruga "Kemajl Azizi" kam një ankesë. Janë diku rreth 50 shtëpi që nuk ju ka ndërru gypi azbezit, aty kundërmonë një erë e keqe dhe 50 shtëpi për shkak të mos ndërrimit të gypit të azbezit kogja e kanë një kundërmim të erës së keqe, për shkak që nuk është ndërru gypi, është një ankesë që ma kanë bërë vazhdimishtë ato shtëpi aty. Pyetja tjetër është për drejtorin e urbanizmit, z.Demiri, tek hartat zonale. Sa keni mbërri me hartimin e tyre, dhe unë po e shofë që kompania konsullente UBT-ja po më duket që e ka për herë të parë këtu në Viti dhe është ka bënë shumë teste, dhe për shkak që kompania nuk ka provojë, po më duket që kogja shumë ka me zgjatë hartimi i hartave zonale. Faleminderit!

**z.Nexhat Halili:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Pyetja e parë ka të bëjë me trotuaret dhe ndriçimin publik. Gati se në secilen seancë është potencu tretuari i cili lidhë 3 fshtra, Trestenikun, Sodovinën dhe Sllatinën e Epërme dhe trotuari në Sodovinë të Jerilive dhe Sodovinë të Muhaxherve. Në kuadër të kësaj edhe ndriçimi publik në Sodovinë të Muhaxherve, mirëpo nuk shihet ende hapa konkret kur do të fillojë puna në këto. Dhe pyetje e dytë është te ujësjellsit i 5 fshatrave. Në seancën e parë kryetari dhe në seancën e dytë nënkryetari ka potencu deri tani se, për shkak të manganit, "Hidromorava" nuk e ka marrë në menaxhim ujësjellësin, mirëpo tani janë bërë ndryshime dhe tani mangani është largu dhe i plotëson kriteret. Kur "Hidromorava" do ta marrë në menaxhim këtë.

**Znj.Lindita Demelezi:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Kërkesa ime është që, në afërsi të shkollave të vendosen vendkalimet e këmbësorëve së bashku me policët e shtrirë dhe të sinjalizohen me shenja vertikale, që nxënësit të jenë më të sigurtë.

**z.Sejdi Emini:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Kam një kërkesë për Drejtorinë e Arsimit, njëkohsishtë edhe për organet komunale. 7 marsi është festë e cila i përkushtohet më shumë arsimit, me 7 mars mbajmë mbramje zakonishtë, gjysen e pagesave të mbrajmës i jek komuna, diku rreth 5 mijë euro, disi po bjen në kundërshtim me atë që nxënësat kur po i mbajnë garat e ditursë dhe garat sportive nuk po ndahet asnjë mjet për me i pru nxënësat me i mbajtë garat e diturisë. Po detyrohen puntorët e arsimit, mësimdhënësit me mjetet vetat. Po ashtu edhe nxënësit me mjetet e veta për me ardhë me mbajtë gara të diturisë ose gara sportive kisha kërku që me u ndërpre. Kjo shpresoj që edhe mësimdhënësit të mirëkuptojnë se, qëllimi është nxënësi më mirë, ato 5 mijë euro është me i orientu në garat e diturisë dhe sportive sa me i dhanë për darka të mësimdhënëseve, se ashtu kështu gjysen e darkave po i hek sindikata disi na e kemi një përgjegjisi që me qenë pak më racionalë pse jo të lidhen edhe bursat e studenteve të cilët

treg me qenë në kuvend ose në komunë ose kryetarë komune, disi po i diskriminojmë. Në këtë aspekt kërkoj që me u rishqyrtu ajo rregullore që ja ndalon atyre mos me gëzu atë të drejtë. Ujësjetllsi në Goshicë ka fillu mu aktualizu prapë. Ajo tema me banorë, banorët dojnë me ditë saktë pse është zhagitë aq shumë kjo punë, ku një pjesë të fajit tani po dojnë me gjujtë edhe në fshatë. Unë besoj që fshati ka qenë i gatshëm, kemi ardh kemi bërë kërkesë, jemi dakordu që me na bë ato shpumje prej një anës në anën tjetër, që me ju mundësu kyqje qytetarëve dhe mos me pas padrejtësi. Janë diku 4 mijë euro të fshatit, më herët që kanë mbet të CDI-ja. Banorët kërkojnë që ato para të kthehen te ata. Ndoshta me ato para të bëhet edhe shpumja, të bëhet një zgjidhje që të dalim nga kjo situatë ku jemi. Faleminderit!

**z.Musli Neziri:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Kam dy pyetje për drejtoreshen e arsimit. Sot pyetjen e parë e kam drejtoreshë, vitin e kaluar, në fund të vitit kalanderik na ka ardhë një njoftim prej drejtorëve të shkollave, që të gjithë puntorët arsimor të cilët punojnë, përshkrimin e pushimit mjekësor duhet ta bëjnë tek i vetmi një mjek në QKMF, dhe si vendim që ka ardhë ose njoftim, unë mendoj që është bërë jo mirë i organizum, sepse tu e ditë numrin e puntorëve që janë në arsim, numër i madh, dhe nevojat e punëtorëve të arsimit mund të jenë të natyrave të ndryshme, të gjithë detyrohen që ta bëjnë përshkrimin tek i njejt i mjek, apo mos vall edhe mjektë ose i kemi diskriminu ose dikënd e kemi ngritë në këtë rast, sepse duhet që vetëm një personë të bëjë përshkrimin e pushimit mjekësor, kur e dimë që në QKMF ka disa mjekë të mjekësisë familjare, në këtë rast po flas nëse e keni pas parasysh që duhet të bëhet përshkrimi te mjeku specialist i mjekësisë familjare. Dhe pyetja e dytë ka të bëjë, në fundë vitit kalendrik, prapë vitin e kaluar jemi në një njoftim që të anulohen pushimet e gjata në shkollat e mesme të Komunës së Vitisë dhe kjo ka shkakto një telashe në organizim, në porcesin mësimor përbrenda shkollave, sidomos 2 shkollat që janë në qendër, dhe tani së fundi ai vendim është zbatu deri diku, tani më prapë shihet që te shkolla e gjimnazit lejon nxënësit, shkolla profesionale jo. Në jemi të gjithë në një dikaster të DKA-së prandaj kërkoj aty të bëhet një vendim. Unë mendoj që, pushimi i gjatë përkundrazi duhet të rritet te nxënësit, sepse ajo ka shkakto rritjen e numrit të mungesave, prandaj pushimi i gjatë duhet të ju lejohet nxënësve, por të gjendet modaliteti, sepse ne po që se i majmë brenda si i kemi mbajtë qe 3 muaj, prej fillimit të gjysmëvjetorit të dytë, shofim se aty në kampusat e shkollave të mesme nuk ofrojmë ndonjë shërbim sikur në komunat e tjera që kanë nëpër kampuset e shkollave. Prandaj është e pamundur që nxënësit të jenë statik nga ora 08:00 e mengjesit deri në ora 12:45 kur kryhet ndërimi i parë ose nga ora 13:00 kur fillon ndërimi i dytë, deri në ora 18:00 është ngarkesë edhe për nxënësit. Kështu që, kjo të kihet parasysh dhe të organizohet një vendim i tillë. Faleminderit!

**z.Remzi Salihu:** Faleminderit kryesues! Unë nuk pata pyetje dhe nuk dashta me diskutu, por thotë populli nxjerrë një kashtë e dalin 6. Du me ju drejtu asambalistes së LDK-së, Arbnores, e cila tha po quditem pse opozita po heshtë për punësimet. Nëse ka qenë pjesëmarrëse e këtij kuvendi, vazhdimisht duhet me ditë se, opozita vazhdimisht i ka ngritë këto probleme, mirëpo po më duket këtu tek ne po vjenë parimi i dhelpres, kur ju ka djegë bishti, e po më duket këtu ka ndodhë një gjë e tillë. Mirëpo këto gjëra kemi mundur dhe do ti paraqesim vazhdimisht, nuk do të ndalemi, po mundësia jonë është t'i adresojmë këtu në kuvend, kurse mundësia juaj është që mos ti bëni fare dhe ti bëni mirë si duhet atje e jo me ardhë këtu në kuvend me na shitë moral.

**znj.Majlinda Shabani:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Pyetja ime e parë është për drejtorin e arsimit, e cila ka të bëjë me sektorin e financave. Dua ta di për cilat lokalitete janë bërë pagesat e transportit për nxënësit me largësi nga shkolla fillore. Dhe pyetja dytë ka të bëjë me ndriçimin publik, ku fatkeqësisht kemi akoma disa lokalitete të cilat kanë mbetur pa ndriçim, ose gjysmë me ndriçim. Bëhet fjalë për fshatin Lubishtë, mirëpo edhe për fshatin Buzovik ka qenë kërkesë e imja që nga fillimi i mandatit dhe që asnjëhere nuk kemi marrë përgjigje dhe nuk është bërë adresimi i duhur. Gjithashtu e kam edhe një pyetje, ose me ngritë si temë, ka të bëjë me çerdhen e cila është duke u ndërtu në Drobesh. E kam parë që udhëheqësit e komunës kanë qenë në vizitë. Kisha dashtë prej nënkryeatrit me na njoftu pak a shumë se si është tu shku puna, dhe për hirë të opinionit, njoftimit të drejtë të qytetarëve prej kujt është financu ndërtimi i çerdhes së Drobeshit.

publike. Kjo kërkesë është në emer të banorëve të lagjes në fshatin Drobesh. Kërkojnë për marrjen e mbeturinave nga kompania "Ekohigjiena", pasi që kjo kompani thojnë ata se nuk ka marrë mbeturina nga lagjja jonë. Në atë lagje janë 16 shtëpi dhe janë në hallë të madh për mos marrjen e atyre mbeturinave. Rruga e asaj lagje nuk ka emër, por është rruga në anën e djathtë në hyrje të fshatit Drobesh, është Lagjja e Dunava dhe Stubllanve. Këta kanë bërë kërkesë, pasi janë 16 shtëpi dhe thonë që i plotësojnë kushtet për marrjen e mbeturinave nga "Ekohigjiena". Faleminderit!

**z.Ali Bajrami:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Pyetjen e parë e kam për drejtorin e kulturës, rinisë dhe sportit. Më intereson drejtor tek subvencionet që janë shpërnda, sa OJQ janë regjistru vitin kalenderik 2021-2022 dhe sa është vlera e këtyre OJQ-ve që janë përfitues. Pyetjen tjetër e kam për drejtorin e shërbimeve publike, pasi që po mungon i bujqësisë, po ja adresoj këtij, po vërejmë në teren që shumë shtylla elektrike janë të djegur, nuk po hy me fshatra, ka qenë mirë, nëse keni mundësi dhe e keni operatorin që të kontraktuar me bë një vëzhgim në teren dhe me i zëvendësu, se po ka kritika prej qytetarëve aty ku janë djegur edhe është një kohë e gjatë po thojnë që nuk janë zëvendësu dhe nuk janë vendosur për ndriçim. Faleminderit!

**znj.Liridona Bislimi:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Kam një pyetje për drejtorin për rini, kulturë dhe sport. Pyetja ime ka të bëjë me palestren sportive në Drobesh. Ne e dimë që punimet e palestres kanë filluar në vitin 2017, me një kod buxhetor i cili është me numër 13454 dhe ka një kosto prej 1 milion e 168 mijë euro. Projekti është parapa të zgjas 3 vite, ka një kohë të gjatë që punimet janë ndalu në këtë projekt, edhe si përfaqesues e këti fshati, për shkak që kemi një numër të madh të rinjeve të cilët janë të interesum, sportdashës, në lidhje me këtë palestër, po më intereson me ditë më detajishtë çka ka ndodhur me këtë projekt, pse janë ndalu punimet dhe kur pritet që të punohet dhe të finalizohet kjo palestër sportive. Pyetja tjetër ka të bëjë me bursat studentore. Ne e dimë që është diskutu një temë ka disa muaj, është parapa që të formohet një komision, mirëpo nuk kemi asnjë informacion. Rreth kësaj teme po më intereson se si qëndron puna nënkryetar, a është formu ky komision dhe a ka fillu me u bë përzgjedhja e këtyre studentëve të cilët kanë apliku për bursa, për shkak se është një nevojë jashtëzakonisht e madhe e tyre të cilët janë duke e mirëpritur në vazhdimsi.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Faleminderit për të gjithë që dhatë kontributin.

**Nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu:** Faleminderit kryesues! Më lejoni të nderuar kshilltarë të ju përshendes të gjithëve, ju media të shkruara dhe elektronike, përfaqesuesi i OSB-së, zyre të kryetarit, bordi i drejtorëve. Pasi që është seanca e parë dhe kemi hy në muaj të Ramazanit, më lejoni të gjithë ata të cilët i përkasin kësaj përkatësie fetare, por edhe ja bëjnë hyzmetin, të ju uroj këtë muaj dhe me dëshiren më të madhe që sa më lehtë ta kalojmë tu e pasë parasyshë gjithë here atë thirrjen tonë që të kemi solidaritetin dhe mirëkuptimin me popullatë por edhe në politikë, megjithatë unë do të bëjë përpjekje për shumë pyetje të cilët janë adresu. Jo rastësishtë e morra fjalën fillimisht, në rastë se grupi i Vetvendosjes ka disponim me më dëgju edhe do të bëjë përpjekje me i dhanë ato të cilët nuk do të përgjigjem, janë enkas pyetje të drejtorive përkatëse. Besoj drejtorat e drejtorive i kanë shënu. Po filloj prej këshilltarit, nuk do ta marrë çështjen e subvencioneve, por do ta marrë te e bërlllogut, për shkak se ju ka dhënë drejtorisë si detyrë përkatse për shkak se fillon me 1 prill dhe përfundon me 22, ditën e tokës. Do të jetë një plan dhe enkas do të jetë Pozherani dhe ajo rrugë një prej atyre prioriteteve për largimin e atyre mbeturinave, megjithatë sa i përket kësaj çështje kem shumë çështje të cilët duhet ndoshta të bëhen, për shkak se inspektorët duhet të jenë më në nivel në shqiptimin e gjobave, se nuk shkon gjithë tu hekë, por duhet të fillojmë edhe mos me qitë. Nuk kam qenë Jakup me pa, megjithatë ne lejen nuk e kemi dhanë, ne e kemi dhanë pëlqimin, lejen dihet kush e lëshon, janë ministritë adekuate, por kurr nuk kemi mendu për me dëmtu lumin, gjithmonë kemi mendu me kriju hapësirë të mirë për zhvillimin e bizneseve. Konkursat dihet se paraprakishtë 1 vit paraprak, vitin 2022 bëhet plani i çdo sektori, në veçanti i Njësisë së Personelit për pozitat e lira të cilët i ka Zyra e Personelit dhe njesia e saj është zyre e kryetarit të komunës. Këtë duhet ta kemi të kuartë, dhe krejtë ato etikime të cilat mundohen me i dhanë, qe 9 vite jam nënkryetari i komunës dhe kurr ende, edhe pse ka pas ankesa edhe në Agjensinë Antikorrupsion edhe në



është tu punu konformë ligjit, prandaj nuk ka nevojë në kuvend të ngriten çështje as familjarizmit as të formave të tjera, për shkak se janë shkallet dhe janë organet përkatëse në Kosovën tonë të cilët munden me ju drejtu gjykatës dhe e fiton landën. Nuk është problem, ne e zbatojmë, qështjet e përgjithshme të preken, por raste individuale është keq, unë po të themë që nuk i shërben askujt, askush nuk e ka të ndaluar me konkuru dhe me u punsu dhe forma mënyra të gjithë ata të cilët janë anëtarë të komisionit, se mu dukë i përmende ata bajnë përgjegjësi për vete edhe janë respektues të ligjit, pse thojmë respektues të ligjit. Profesori i nderuar Esat Stavileci i cili më ka ligjeru edhe mu, thojke, një dokumentë konsiderohet i vërtetë deri sa për të njejtin nuk vërtetohet e kunderta dhe unë asnjë provë nuk e kam të kundërt, por i kam kështu. Rruga "Hysen Terpeza". besoj drejtori e ka kontratën dhe do të jetë ai i cili do të përgjigjet. E di që në kontratë e kemi pas gypin kryesor me ndërru të azbesit. Tash a ka qenë ky gyp a nuk ka qenë, nuk e di, mundet me kundermu, munden me qenë edhe gjërat e tjera të cilet munden me kundermu, por duhet ti gjejmë format për me i eliminu së bashku me hidromoravën dhe me i ndërru, trotuaret dhe ndriqimi publik. Është e vertetë Nexhat, e ke shtru shumë here, ishte projekt 2-vjeçar dhe së shpejti do të filloj sipas inxhinerit mbikqyres, por do të ndalem më shumë te ujësjellësi, te fshatrat se jam marrë bukur shumë me këtë çështje. Është e vertetë se, krejt prej ditës së parë kur mangani ka dalë i lartë e deri tasht i kam edhe kopjet për shkak se jam interesu maksimalisht për këtë çështje e dinë edhe kryetarët e fshatrave, megjithatë takimin kur e kemi pas për me marrë tash kemi të bëjmë edhe më një udhëheqje të re në "Hidromoravë", nuk është ai kryeshefi për është një tjetër dhe realishtë ka kërku që duhet me u formu një komision dhe me bë pranimin teknikë kemi pajtu edhe ne si komunë edhe pse CDI që ka qenë obligative është dashtë me bë të gatshme për me dalë komisioni për pranim teknikë dhe tani me dhanë, por nuk mundemi të bisedojmë më për CDI, se ajo nuk përgjigjet, e kemi marrë ne përsipër si komunë dhe komisioni ka dalë dhe ka bërë një vlerësim, ma ka pru një paramas, një parallogari. Është ka e bënë edhe të Debelldehit dhe së shpejti do të del të tenderohet dhe të kryhen ato mangësië të cilët na ka dhanë komisioni për pranim teknikë që i paska disa mangësi ata 5 lokalitetet i dinë më shumë, bile kanë pas edhe probleme për shkak se as projektin nuk kanë mujt me siguru nga CDI. Më tepër kanë bisedu me kryetarë të këshillave të fshatit dhe banorë të cilët i kanë tregu defektet që janë parë, ndoshta jo edhe saktësishtë, por ato të mundëshme dhe unë besojë se hapin e parë me ujë kemi me bë për këto 5 fshatra dhe kanë me u marrë me menaxhim. Mos mu lidhni për afate, se sa ka me qenë ajo procedurë si i kemi kompanitë tona marak me u anku, por hapi i parë që do të bëhet janë 5 fshatra së bashku me Dobolldahun kan me shku paketë. Unë e di Lindit, por e ki edhe drejtorin me siguri, se e patëm edhe rrugës që e ka bërë kërkesën për shpalljen e tenderave dhe vendosjen e shenjave dhe të policëve të shtrirë aty ku ka nevojë, të cilët vendosin eksperetet për atë se ku duhet të jenë. Sejd, ndoshta në këto të cilët ke bë një dallimë mes datave, por megjithatë edhe ti pajtohesh sikur unë se 7 marsi është datë fikse historike që e garave nuk është ajo, mund të ndryshoj, por a kanë nevojë ata nxënës për ndihmë dilem nuk ka, kanë, por 7 marsi nuk mundemi me i ik. A mundemi me reduktu në shpenzimet, tasht duhet me pas edhe mirëkuptimin, se gjithëhere sindikata kur të vjen, ne mendojmë se është mendim i krejt personelit arsimor, se ai e përfaqëson një trup. Është një kërkesë dhe gjithëhere ne e kemi miratu tashë me ardhë që forma organizative ti pe dinë puntoreve tashtë është përmes formave sidikale ata janë antar dhe munden me ardhë me thanë ne po e reduktojmë këtë qështje por po i qojmë në këtë anë nuk na prishë neve punë idet e mara dhe të mira i përkrahim, tek bursat kjo ka ndodhë edhe po ndodhë qe 5-6 vite edhe sivjet ndodhë ashtu për shkak se e kemi një rregullore e cila është në fuqi që unë së bashku me një grup të juristave të cilët janë të intresum shumë me ndihmu këtë proces që nuk po dua të i përmendë me emra në mesin e tyre qenka një këtu por i kem 3-4 që vinë konsultohem vazhdimishtë por i kam parë akte normative të brendshme të tona të cilët kan nevojë për ndrrim e kam parë edhe këtë sikur që e kam parë rregulloren e kuvendit ndoshta ish momenti që duhet me i hi me ndrru përshkak të proceseve të cilët kan ndryshu dhe kur e bëjnë ndryshimin e kësaj ju do të jeni ata të cilët do ta vendosni se rregullorja vjen nga propozuesi në kuvend dhe ju jeni ata të cilët ja jepni bekimin që konkurentë me qenë edhe këta që studiojnë në universitete private, ujsësjellsi për këto 4 mi euro nëse i ke te CDI-ja më vjen keq që tek është shumë problematikë Sejd ne e kemi pasë me kryeshefin e hidromoraves kur e kemi

kurrë e di atë megjithatë ka qenë mirë ju me lëvizë me këtë drejtim me fillu ju aty ku nuk ka shpime me kqyr me fillu kyqjen dhe këtë qështjen tjetër një ditë me shtru ne si problem se CDI mo nuk është dhe me kqyr qka mundemi me bë por kyqjet individuale nuk bënë ne mi bë të kam thanë edhe atëhere dhe tashtë përshkaka se është një sistem shumë i gjërë që gjithësecili se kjo është sikur rryma ta bjenë deri aty shtyllen elektrike ndesh e merr ndesh jo edhe uji ta bjen gypin me dashtë me marrë e merrë, prof si e ka të rregullume QKMF-ja këtë qështje pushim mjeksorë me dhanë e di që me lokalitete i kanë të ndame cilët pacient tash a i kanë të ndame si kategori njerzore që profet me u kontrollu te ky mjekë këtë nuk e di do të konsultohem dhe do ta japë informacionin e plotë tash i shkrujta drejtoreshes por hala nuk kam marrë përgjegjje, qështja e pushimit të gjatë edhe të shkurtë ti e dinë që në atë kohë ka propozu ish drejtoresha që është menaxhere për procesin edukativo arsimorë ka mendu gjithë here për të mirë përshkak me u shu problemet mos me ju lanë hapsirë shumë nxënsëve dhe me i pasë në formën më të mirë të kontrolluar megjithatë unë konsiderojë se tash e kemi një drejtoreshë tjetër që të dyat kan ambicien që procesi arsimorë të zhvillohet sa më mirë dhe të ketë edhe suksese më të mëdha edhe numer të mungesave më të vogla megjithatë është mirë aty ku punoni drejtorit tëndë me i thënë se këta i kanë edhe mbledhjet aktive edhe drejtoret që me shtru këtë qështje në rastë se ka rezultu negative ajo nuk është bibel apo kuran ju mundeni me jekë edhe me ndryshu dhe me i ofru akte normative të cilët me të vërtet tregojnë rezultat, ndriqim publikë Majlindë kemi bë sa dush edhe do të bëjmë hala por Lubishta nuk keni arsye me u anku për ndriqim publikë se prej Ramnishtë e deri në Lubishtë e keni, qerdhja e Drobeshit është një marrveshje mes komunës dhe ministrisë projekti është 2 vjeqarë kërkesa e kryetarit të komunës ka qenë a ka mundësi nga ana e kontraktuesit të kryhet kur është bërë vizita dhe sipas gjitha gjasave duket një kontraktues serioz dhe ka thënë që do të bëjë përpjekje me kry sivjet në rastë se ka mjete të mjaftueshme e kryjnë kërkesa jonë që me 1 shtatorë me mujtë fëmijët me i vendosë aty por megjithatë kontrata është 2 vjeqare aspekti ligjorë dhe kontraktues nuk e obligonë për sivjet vullneti i tijë dhe kapitali si kompani në rastë se është ai mundet me kry dhe paret të cilat i ka të përcaktuara i merrë në vitin 2024, lagjja në Drobesh për marrjen e mbeturinave besojë që e ki drejtorin e sherbimeve publike kjo duhet të bëhet kërkes edhe në eko higjen dhe në rastë se i plotsojnë kushtet ata janë për atë punë me marrë bërlllogë dhe me i qu në vendin e duhur, në fundë ka qenë Alia 2 drejtoret janë këtu edhe për OJQ edhe për vëzhgim të terenit të shtyllave elektrike ata mundë të përgjigjen Faleminderit shumë për kontributin e juaj edhe pyetjet që i keni ngritë sot.

**z.Valmir Sahiti, drejtori:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit, më lejoni që të i japë disa sqarime të nevojshme për disa pyetje që u ngriten në drejtorin për kultur rini dhe sportë, Iliri ngriti punën rreth procedurave të subvencioneve dhe kohën kur pritet të përfundojnë ato ne e kuptojmë nevojën e madhe të klubeve dhe të organizatave që të ju dalin mjetet sa më parë për shkak të nevojave dhe kërkesave të tyre të mëdha për këtë qëllim komuna e Vitisë është njëra ndër komuna që qysh në fillim të vitit e ka hapë thirrjen publike në mënyr që të jemi me kohë në afat neser publikohet komisioni i cili do ta bëjë vlersimin e këtyre thirjeve publike dhe konfrom procedurave gjatë muajit prill besojmë që kjo qështje do të përfundojë, z.Ali Bajrami ka ngritë pyetjen rreth numrit të organizatave jo qeveritare që kan përfituar gjatë vitit 2022 dhe vitit 2021, në vitin 2022 kan përfitu 22 organizata jo qeveritare vlera ka qenë rreth 50 mi euro prej tyre jan egzekutuar 49 mi e 900 euro rreth vitit 2021 edhe pse në atë kohë nuk kam qenë drejtor i kësaj drejtorie informacionet që i kam kan qenë 15 OJQ me 38 mi euro fond më lejoni po ashtu që të i përgjigjen edhe shqetsimin të ngritur të kshilltares Liridona Bislimi rreth palestres së sportit të qytetit të Vitisë përshkak që ajo palester nuk është vetëm e një lokaliteti por është palester e qytetit të Vitisë është e vertet që në këtë palester punimet janë tejzgjatë problemi kryesorë që kompania i ka ndërpre punimet ka qenë vitin e kaluar ngritja e qmimeve një problem që ka hasë edhe në shumë projkete të tjera para 2 dite kam pasë një takim në ministrin e kultures me sekretartin e ministris z.Feim Hoxha dhe po besojë që shumë më në fundë po lëvizim në këtë drejtim rreth zhbllokimit të kësaj sijuatë uroj shuëm që edhe ministri i kulutres ta ketë vullnetin dhe dakordanven që jemi mirrë veshë me sekretarin e ministris që nuk dua të paragjykojë por kemi pasë një takim shumë konstruktivë grupet punuese menaxhert e projetkeve edhe inxhinierat në nivel lokal edhe të ministrisë janë duke

të ri bashkpunimi në mesë të ministrisë së kultures dhe komunës së Vitisë dhe po besojmë shumë që më në fundë qështja e palestres së sporteve në Viti ta marrë epilogin e sajë dhe të jetë në shërbim të qytetereve të Vitisë respektivisht të OJQ dhe klubeve sportive që veprojnë në komunën e Vitisë.

**z.Visar Demiri, drejtori:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit, te pyetja e Taulantit për hartat zonale ju informojë se pas nënshkrimit të marrëveshjes me kompanin e UBT-s për hartimin e hartave zonale kompania ka fillu përgaditjet mirpo ne siq e dini jemi në përfundim të miratimit të planit zhvillimorë komunalë po shpresojmë që muajin e ardhshëm do ta kemi në rend ditës këtu në kuvendë dhe më vonë do të punojmë intenzivisht me hartat zonale për të cilat nuk mundet të miratohet 9 muaj pasi të miratohet PZHK kështu që besoj si jemi dakordu edhe me kryetarin e komunes javen e kaluar me UBT diku deri ka fundi i vitit po mendojë që do të i kemi gati edhe hartat zonale.

**z.Basri Aliu, drejtori:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit, ishin disa pyetje lidhje me drejtorin e shërbimeve publike nga asambleistet po mundohem të japë përgjigje, Sokoli pyeti për rrugën e Terpezës realishtë ne kemi fillu qe 4-5 ditë mei mbyll vrimat nëpër rrugë në territorin e komunës së Vitisë është e parapame edhe pjesa e rrugës së Terpezës brenda kësaj jave besojë që do të përfundojë, për Drobesh për marrjen e mbeturinave në atë lagje Zejnep kemi bisedu jamë në rrjedhë por problemi kryesorë është që rruga është shumë e ngushtë dhe automjeti i ekohigjenes nuk mundë të hy dhe të kthehet aty prandaj atyre ju ka preferu që të i bartin deri tek një vendë që ti marrin për këtë arsye është problemi se në qoftë se hyhet në atë rrugë edhe një vetur tjetër me ardhë atëhere bllokohet kamioni, Aliu e përmendi për ndrrimin e shtyllave apo zëvendësimi i ndriqimit Ali u shkru një kontrat me një kompani Slovene e cila është duke e bërë ingjizimin e terenit dhe ka me ndrru gjithë ndriqimin ku është por edhe aty që nuk janë kemi me vendosë në mënyrë që të jetë në kuader të efijentes të energjisë prandaj kanë mbetë dhe kemi mjaftë defekte nëpër këto egzistuese në momentin që fillon me i vendosë ato atëhere i ka për obligim 10 vite të i mirëmbajë ato.

**z.Adnan Ymeri, drejtori:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit, z.Jakup Demiri e parashtroi pyetjen e disa qështjeve të disa mbindertimeve pa leje që ka të drejtë për shqetsimin e paraqitur gjithashtu jem të shqetsuar edhe ne si drejtori dukuria negative dhe antiligjore e ndertimeve pa leje nga ana e drejtoris insoeksionit konkretisht inspektori i ndertimit si udhëheqës i procedurës administrative inspektuese është inspektuar dhe janë marrë edhe disa procedura ligjore në disa vende gjë që për shkak të informimit dhe privatisis nuk jam i autorizum me cekë emra konkretë ku ose në cilin vendë të njejtit nuk e kanë respektuar vendimin e inspektorit gjë që kemi ardhë në përfundim deri tek dorzimi i kallzimit penal në prokurorin themelore shtetrorë në Gjilan jan dorzuar kallzimet penale për 2 vepra penale që është ndertim pa leje që është e denushme deri në 5 vite burgim dhe është dorzuar edhe për heqjen e shiritit shtetrorë që është e denushme deri në 3 vite burgim tash e tutje këto landë janë në prokurorin themelore Gjilan nëse lëshohemi në thelbin e paraqitjes të kësaj dukurie negative dhe antiligjore janë shumë faktorë të ndryshem që ndikojnë mirpo nuk jam i thirrur të lëshohem në ata por parimishtë nga ana ime është dhe jam i obliguar të kjarsoj dhe spjegojë që procedurat inspektori i nderimit i ka zhvilluar ndaj ketyre të këtyre veprave anti ligjore, pyetja e dytë ishte nga asambleistja Lindita Demelezi që ka të bëjë me vendosjen e shenjave horizontale në vendet e frekuentuara siq janë shkollat ambullantat afer qytetit dhe jam i obliguar të ju informojë që në vitin 2022 vetëm vendkalimet e këmbësoreve që i kemi shenjëzuar janë diku 1700 metra katrorë të njejtat vendkalime janë shenjëzuar që ne i quajmë dy komponentë dhe vezëllues apo ndriques tek shkollat i kemi bërë dy ngjyrshë edhe në qytetet e kemi bërë edhe ngjyren e kuqe edhe ngjyren e bardhë që me qenë sa më reflektues për vozitësit.

**Znj.Arta Ajeti, drejtoresha:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit, në seancen e kaluar kam pas një pyetje nga kshilltari z.Ali Bajrami sa kemi ramje të numrit të nxënseve për vitin kalenderik për vitin 2021-2022 dhe 2022-2023 sipas sistemit SMIA në regjistrimin e nxënseve që bëhet në shtatorë kemi pasë një diference të numrit të nxënseve për vitin 2021-2022 ka qenë diku 7329 nxenes ndersa për 2022-2023 është 7202 nxenes domethan rëmja e numrit të nxënseve nga numri 2022-2023 është 127 nxenes sipas sistemit SMIA, Faleminderit.



paska pas kërku me shkresë që të caktohet një dokoreshë që është më e besushme në këtë rastë dokoresha Gjylë koka caktu dhe nuk është problem për me ndrru por nuk më ka shkru se a duhet të ketë mjekë me pasë aty por po deshka em caktu në këtë formë përgjegjja prej drejtoreshes së QKMF-s se të meta mangut.

**z.Jakup Demiri:** Drejtorë po më vie mirë që një pjesë të procedurës qka është në përgjegjsinë tënde eke procedu aty ku është puna por kjo puna e mos me përmendë emra mos me ditë është mirë me ditë kush nga inspektorët e kan rastin se këtu në Viti nuk është vetëm ky rastë kemi pasë inspektorë edhe vitet e kalume ata janë marrë me punën por ndertimet kan vazhdu kemi 10/11 katë ndertim pa leje në Viti, mua nuk më pëlqen kjo që veq ta jeki përgjegjsinë nuk sho një vullnetë te ju dhe te qeverisja në Viti të ndalen po më duket që është mirë me kriju një llojë kauze për këtë punë se veq ta jeki përgjegjsin më heret as përgjegjsin se kan jek ti po thu e ke jekë përgjegjsinë mirë por këtu kemi me të mbajtë edhe për këto fjalë që i ke thanë sotë edhe në të ardhmën por nuk mjafton ndertuesit tjerë më heret kan ndertu me pëlqimin me marrveshje të mshefta që i dimë me komunën se kemi edhe familjarë që ndertojnë edhe kjo është ashtu vazhdonë veq e ki shancen me u bë edhe personalitet përime me e tregu edhe veten jo veq ta jeki si përgjegjsi se këtu ne këta që jemi këtu edhe në asamble edhe ju që jeni në qeveri për këto dukuri që janë teper negative ne kemi me bajtë etiketen e nderitmit jo ndertuesit Faleminderit por me këto do të mirremi edhe në të ardhmën.

**Znj.Arbnora Hajredini:** Faleminderit shumë, nuk e kam ndegju asnjëherë që është diskutu puna e listës këtu, nënkryetarë nuk ma spjegove me cilin ligjë funksionon lista.

**z.Basri Sylejmani:** Është qështja tek shërbimet publike por ka fillu një rrugë në Sodovinë është rrugë e arave e bujqësis ju kisha lutë nënkryetarit që me ja përcjell kryetarit ose kush e ka atë është për 200 metra me dalë me u lidhë me Sllatinë se rruga e Gelbushit veq nuk është tu lidhë ajo përshkak se është një pronë nuk po donë me lëshu ai pronën e kjo rrugë e lidhë edhe Sllatinen, Germovenm Sodovinen te shpija ime në qoftë se e dinë ku është rruga Sylejmani unë nuk e kam asnjë pllam tonë aty por masi është për mu lidhë neser bëhet ndonjë gjë në komunikacion munden me u lidhë aty dhe me pasë lidhje për 200-300 metra pse me u lidhë ajo rrugë këtë kisha pas dëshirën që me propozu për mu lidhë se është tu punu tashtë pse me dalë 2-3 here kur se është meniher me u lidhë për 200 metra me Zhavorrë edhe me u lidhë me Sllatinë ajo rruga që vjen prej vorrezave Sllatinës e delë në Germovë te kta romët që kan qenë përpara.

**z.Illir Zuka:** Drejtor faleminderit besojë që këtë muaj që vjenë e përfundojë përshkak të gjendjes që janë klubet e dinë edhe shoqërit e OJQ-t e krejt tjerat veq du me u nderlidhe me nënkryetarin fortë mirë e cekin e kemi pasë të njejtin problem tek rruga Haxhi Emiri mbi 3 muaj i ka që nuk mundemi me zgjidhë një qytetarë i pa ndërgjegjshëm që e ka mbyll kanalën dhe është duke domtu kompletë atë pjesën e asfaltit dhe nuk janë duke mundur të bëjnë zgjidhje është kompletë që lidhë rruga Sabit Zuka me rrugën Haxhi Emiri është i njejtin problem edhe e kisha lutë drejtorin e urbanizimit prej 1 prillit që është lista plus që delë tashtë dhe shikonë që të jetë një ndër të parët që duhet të intervenohet për shkak që është një pasqyrë e komunës nuk bënë të jetë ashtu përshkak që ne i kemi edhe fotografitë drejtor i inspeksionit njerzit tu hudhë mbeturina veq na tregoni një adresë ama tamanë me u ndermarrë se problemin me rrugën Haxhi Emiri e dinë edhe në cilsin e administratorit ta kam dhanë edhe emrin kush e ka blloku edhe ka kalu mbi 3 muaj su ndermarrë asgjë.

**Znj.Majlinda Shabani:** Faleminderit kryesues deshta me u nderlidhe te puna e ndriqimit publike ku nënkryetari tha që mundemi me marrë shëmbull fshaitn Lubisht unë në faktë po du me i tregu kryetarit që në lagjen ku unë banojë gjysma e lagjes është me ndriqim gjysma pa ndriqim nëse ti nuk e beson këtë unë të bëjë ftesë me ardhë në rrugën ku unë banojë në lagjen që unë banojë ku është rruga Sali Zenuni është vend që nuk ka ndriqim nuk di edhe nuk po du me besu me pas bindjen që ndoshta edhe ndriqimi i viteve paraprake është bë ndoshta edhe në bazë të bindjeve partiake ose në bazë të përkrahjes që e keni pasë ju kështu që shpeshë here e shofë që ndoshta vullneti për lavdata është shumë por vullneti për punë mungon pajtohem që kenio punu shumë sa i përket trotuareve për qdo vitë ndertoni rindertoni rregulloni mirpo duhet kaniher me pa edhe mënyrën se si po ndertohet edhe kualitetin

kohëzgjatja ose 2 vite 3 vite hajde po them 5 vite dhe në fundë prapë me vazhdu prej fillimit Faleminderit.

**Znj.Lendita Demelezi:** I nderuari drejtor unë kërkova që të ketë polic të shtrir së bashku me vendkalim tek shkollat

**z.Remzi Salihu:** Faleminderit kryesues nuk po e zgjati shumë vetem Arbnore po i themë ne kemi thanë ja ujku ju po thuni ja tragi gjurmet Faleminderit.

